



# Gjeomonumentet në Shqipëri


<b>Nr. rendor:</b>	2	<b>Emri:</b>	Liqenet e Belshit		
<b>Qarku:</b>	Elbasan	<b>X:</b>	4406859	<b>Tipi:</b>	Gjeomorfologjike-Karstike
<b>Bashkia:</b>	Belsh	<b>Y:</b>	4538961	<b>Kategoria:</b>	Kombëtare
<b>Njesia Admin:</b>	Belsh	<b>Z:</b>	160	<b>Cënueshmeria:</b>	
<b>Plansheti:</b>	K-34-112-B-b	<b>Statusi Mbrojtjes:</b>	Është shpallur shesh në mbrojtje me VKM nr. 676 dt. 20.12.2002		
<b>Zona Tektonike:</b>	Jonike	<b>N/zona:</b>	N/zona Berati	<b>Mosha</b>	T3(ev)

## Pershkrimi Gjeologjik:

Liqeni i Belshit ndodhet në Belsh në anën lindore dhe jugore të qytezës së Belshit. Është liqeni më i bukur dhe më i përmendur i zonës, i cili ndodhet pranë fshatit Belsh. Kuota e pasqyrës së nivelit të ujit në dimër arrin 154.10 m abs., kurse në verë arrin 149.70 m. Siç shihet ndryshimi i nivelit të ujit arrin në 4.40 m, gjë që vjen më tepër, si rezultat i shfrytëzimit të ujit për vaditje. Ky liqen nëpërmjet një kanali artificial lidhet me përenjtë e sistemit të lumit Shkumbin. Ka një sipërfaqe prej 26.9 ha dhe një volum uji prej 1.455.000 m<sup>3</sup>. Thellësia më e madhe prej 13.1 m gjendet në jug të liqenit, në mes të dy ish stacioneve të pompimit. Thellësia mesatare e tij është 5.4 m (Pambuku A., etj., 2006). Në verë një pjesë e mirë e sipërfaqes së liqenit, në pjesën veriore, del në të thatë dhe përdoret si tokë buke. Liqeni është i rrethuar nga kodra, të cilat nga perëndimi, jugu e lindja bien pothuajse thikë mbi të, ndërsa nga ana veriore shpatet e kodrave bien ngadalë, duke formuar sheshe të përshtatshme për banim. Në këtë breg ndodhet edhe një liqen i vogël kënetor. Liqeni i Belshit te ofron nje pamje piktoreske te qendres se qytetit. Shfrytëzohet për peshkim dhe ujitje

**Vlerat:** Ky gjeomonument ka vlera shkencore, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike, didaktike dhe gjeoturistike

**Arritshmeria:** Vizitohet duke marrë rrugën Elbasan-Belsh-Qendër



**Literatura:** Neziraj A. rtj., 2017; AKZM+Internet

**Plotësoi skedën:** Adil Neziraj